



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

KABINETI I MINISTRIT
KABINET MINISTRA
THE CABINET OF MINISTER

Prishtinë , 10 qershor 2010

Fjalimi i zëvendësministrit të MTI-së, Januz Kastrati në hapjen e Panairit "NATYRA 2010"

I nderuar ministër Stavileci,
E nderuara znj.Meri Hobs, drejtoreshë në USAID,
Zonja Arieta Vula Drejtore ekzekutive e SHPKD,
I nderuar, z. Gërzhaliu,
I nderuari, z. Deshishku,
Mysafir të nderuar,
Zonja dhe zotërinj.

Është kënaqësi e veçantë për mua dhe për institucionin të cilin e përfaqësoi të jam prezent në këtë panair tradicional të gjashtin me radhe 'NTYRA 2010' të përpunuesve të drurit i cili panair për ç'do vit është duke shënuar rritje në pjesëmarrje dhe është duke zgjuar interesim të veçantë si të kompanitë vendore ashtu edhe të huaja .

Më lejoni të përshëndes organizatoren e panairit "Shoqatën e përpunuesve të drurit" kompanitë vendore pjesëmarrëse në këtë panair, kompanitë nga Shqipëria ,Italia, Gjermania, Kroacia , Serbia. dhe vendet tjera pjesëmarrëse si dhe një falënderim të veçantë për institucionet donatore si USAID përkatësisht projektin KPEP(Projekti për ndërmarrjet Private në Kosove) dhe APIK si përkrahës dhe mbështetës të vazhdueshëm këtij sektori të rëndësishëm dhe konkurrues në Industrinë Kosovare

Kam obligim institucional dhe moral, të ofroi një bashkëpunim dhe mbështetje të evenimenteve të këtilla ku shihen rezultatet e arritura të kompanive vendore në këtë sektor, dhe të bëjë përpjekje që në të ardhmen e afërt prodhimet e kompanive kosovare të jen konkurruese në tregjet e rajonit dhe tregun e BE-se.

Sektori i përpunuesve të drurit sidomos viteve të fundit ka pasur vërtet një zhvillim dhe rritje signifikante, si në përdorimin e teknologjive dhe diturive të reja në kualitetin e prodhimit, dizajnit dhe në arritjen e marrëveshjeve për eksport me disa vende të rajonit e më gjerë.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

KABINETI I MINISTRIT
KABINET MINISTRA
THE CABINET OF MINISTER

Duhet përmendur se MTI-ja ka pas angazhim të drejtpërdrejtë dhe bashkëpunim të ngushtë me projekte të donatorëve, si: USAID, KPEP, GTZ, Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian për ngritjen e kapaciteteve të këtij sektori përmes organizimit të shumë punëtorive, ofrimit të trajnimeve në hulumtim të tregut, ngritjes së kualitetit, si dhe në marketing dhe në implementim të standardeve HASAP dhe ISO.

MTI-APIK këtë vit do të përkrah me shume se 23 programe të organizimeve të tilla të panairëve misionëve shitëse dhe blerëse për bizneset kosovare të sektorëve të ndryshëm me qëllim të ngritjes së konkurrencës, gjetjes së tregjeve të reja dhe marrjen e përvojave me të mira në ngritjen e kualitetit dizajnit dhe përmbushjen e standardeve për të rritë mundësitë e eksportit të produkteve tona në tregjet ndërkombëtare.

Te nderuar pjesëmarrës në këtë panair, me lejon të them se sektori i përpunuesve të drurit parqet sektor shumë atraktiv janë të evidentuar në MTI mbi 1480 biznese si përpunues të drurit, dhe kanë mbi 5000 të punësuar prandaj kapacitetet në këtë sektor gradualisht po i tejkalojnë kërkesat e konsumit të tregut vendor , jam i inkurajuar me pjesëmarrjen e prodhimeve të këtij sektori edhe në tregjet rajonale dhe në tregun e bashkimit evropian, synimet tona janë depërtim ma i madhe i këtyre prodhimeve në këto tregje dhe janë duke u bere përpjekje që përmes mbështetjes së drejtpërdrejt të kompanive – ndihma në marketing, sigurim pjesëmarrje në panairë ndërkombëtare, takimeve B2B , misionëve shitëse dhe blerëse të ju mundësohet kompanive përfitim i përvojave të reja të avancuara ngritje të konkurrencës dhe përshtatje të kërkesave të tregjeve ndërkombëtare , duke arritur kështu në Objektivin kryesor të kësaj industrie:

Ngritjen e konkurrencës për tregjet e eksportit dhe njëkohësisht edhe të tregut vendor (ulja e importeve, ngritja e shitjeve vendore dhe eksportuese)

Në fund me lejon që të ju dëshiroj pjesëmarrje të suksesshme në panairin Natyra 2010

Ju faleminderit!